



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT

RAPORTI MONITORUES

2019

mbi punën e legjislativit të komunës së
Shtimes

Qershor 2019

Përmbajtja:

Hyrje,	Faqe 2
Përmbledhje	Faqe 3
Komuna e Shtimes	Faqe 4
Notimi	Faqe 5
Kategoritë	Faqe 5
Periudha kohore	Faqe 5
Legjenda	Faqe 5
Rezultatet e fletë-notimit për kuvendarët e kuvendit	Faqe 6
Rezultatet e fletë-notimit për subjektet politike	Faqe 7
Lista e raporteve dhe informata të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2019	Faqe 9
Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2019	Faqe 9
Lista e kërkesave të aprovuara nga Kuvendi komunal të vitit 2019	Faqe 10
Burimet	Faqe 12

Adresa: Rr."Tahir Sinani" 14000 Shtime

Tel.+377 (0) 44 786 414

e-mail: info.yahr@gmail.com

Ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Facebook: <https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"



Organizata Joqeveritare YAHR ka zgjeruar aktivitetet e monitorimit të legjislativit në Komunën e Shtimes ,për periudhën e ardhshme tre vjeçare 2019/2021 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga ky vit ka filluar monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Shtimes. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Shtimes për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Shtimes, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Shtimes.

Raporti i parë monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Shtimes, karakterizohet me zhvillime në interes të qytetareve. Me gjithë atë YAHR-i është mundur që të hartojë një raport, duke u mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të mediave të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi
Drejtör ekzekutiv i YAHR-it



PËRMBLEDHJE

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit të punës së legjislativit në Komunën e Shtimes gjatë periudhës Janar-Qershor 2019. Monitorimi është fokusuar në Asamblenë Komunale dhe organet tjera të këtij Kuvendit.

Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletë notimit kemi konstatuar këto fakte:

- Gjatë periudhës janar – qershor 2019 kemi tre kuvendarët më aktivë që kanë kontribuar me debate , me pyetje dhe në ngritje të çështjeve të ndryshme që janë në interes të qytetareve të Komunës së Shtimes dhe ata janë: Fehmi Hysenaj nga subjekti politikë NISMA 232 Pikë, Ruzhdi Jashari nga LVV-ja me 199 Pikë dhe Naim Zejna nga LDK-ja me 182 Pikë. Ndërsa, kemi tre kuvendarët të cilët me më së paku kanë kontribuar në mbledhjet e kuvendit dhe ata/ ato janë: Fatmire Ferati nga PDK- ja 12 pikë, Milot Deliu nga PDK-ja me 8 pikë dhe Zarife Rexhaj nga LDK-ja me 4 pikë. Është e çuditshme se gjatë kësaj periudhe kem një kuvendare “memece”, Diarta Vishesella nga subjekti politikë AAK-ë, e cila nuk ka folur asnjë fjalë të vetme gjatë këtyre gjashtë seancave të monitoruar nga ana monitoruesit tanë.
- Subjekti politikë më aktiv gjatë kësaj periudhe raportuese është PDK-ja e cila është e përfaqësuar me 8 kuvendarë dhe ka grumbulluar 368 pikë në bazë të notimit të bërë nga ana monitoruesit tanë, pastaj vjen Lëvizjen Vetëvendosje me 3 kuvendarë e përfaqësuar, e cila ka grumbulluar 354 pikë dhe subjekti i tretë politikë është “Nisma” me 285 pikë, e cila është e përfaqësuar vetëm me 2 kuvendarë në Kuvendin komunal të Shtimes.
- Nga 6 seancat e mbajtura në periudhën janar – qershor 2019 kemi 11 vendime të aprovuara nga kuvendarët dhe 9 raporte apo informata të prezantuara nga ana e ekzekutivit para kuvendareve të Kuvendit të Komunës së Shtimes.
- Sfidë kryesore e pushtetit lokal në komunë e Shtimes mbetet mungesa e transmetimi i seancave “live” të kuvendit komunal. Mungesa e këtyre transmetimeve shpeshherë kuvendarët po ndjehen komod në debate të ashpra dhe ofenduese. Transmetimi i mbledhjeve të KK-së në mënyrë të drejtpërdrejtë do të kontribuonte në një transparencë dhe llogaridhënie për të gjithë, andaj mendojmë se një gjë e tillë duhet të ndodh brenda një të ardhme të afërt. Kjo do të parandalonte edhe gjuhen denigruese të këshilltarëve derisa janë nën përcjelljen e qytetarëve dhe institucioneve tjera,

KOMUNA E SHTIMES

Komuna e Shtimes gjendet në skajin perëndimor të Rrafshit të Kosovës dhe përfshin pjesën ndërmjet rrafshit të Kosovës dhe hapësirës malore të Carralevës, që shtrihet deri në Drenicë dhe bashkë me malet e Jezercit dhe të Nerodimes e ndajnë Rrafshin e Kosovës nga Rrafshi i Dukagjinit. Komuna e Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km², gjegjësisht, 1,2 për qind të territorit të gjithmbarshëm të Republikës së Kosovës dhe kufizohet në juglindje me Komunën e Ferizajt, kurse në verilindje



me Komunën e Lipjanit dhe në perëndim me Komunën e Suharekës. Komuna ka 23 vendbanime duke përfshirë qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore-malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore. Qytetin e Shtimes e përshkon lumi më i rëndësishëm Shtimjanja, në të cilin, para hyrjes në Shtime, derdhen lumi Carraleva, Topilla dhe Mollopolci. Pellgu i këtij lumi ka një sipërfaqe prej 14 km² dhe, prej burimeve të tij e deri te derdhja në lumin Sitnicë të Lipjanit, është i gjatë rreth 15 kilometra. Qyteti i Shtimes është 31 km larg nga kryeqyteti i Kosovës (Prishtina), 48 km nga Prizreni dhe 13 km nga Ferizaj. Gjithashtu largësia e Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Sllatinë është 29 km. Pra, Komuna e Shtimes ka pozitë të përshtatshme gjeografike, ngase gjendet pikërisht në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme dhe efektive në relacionin Prizren – Prishtinë dhe Prizren – Shkup. Po ashtu kjo pozitë e volitshme gjeografike mundëson hyrje-dalje (në Duhël të Suharekës), në autostradën “Ibrahim Rugova” (20 km), kurse në dalje të Lipjanit lidhet me autostradën “Arbën Xhaferi” (16 km).

Pozita gjeografike e komunës së Shtimes me 1,2 për qind të sipërfaqes që përfshin territorin e gjithmbarshëm të Kosovës. Sipas regjistrimit të bërë në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, është konstatuar se në komunën e Shtimes jetojnë 27 mijë e 324 banorë (13.850 meshkuj dhe 13.474 femra), me një dendësi të popullsisë 203.91 banorë/km² dhe moshë mesatare 27.62 vjeç. Nga këto shifra del se prej 34 komunave, në të cilat është bërë regjistrimi i popullsisë, Shtimja është komuna e njëzet e katërt me radhë për ka numri i banorëve. Komuna e Shtimes është hapësirë gjeografike, ku 96.79 për qind të popullsisë e përbëjnë shqiptarë, 2.74 për qind ashkali dhe 0.46 për qind grupe tjera etnike (minoritare).

NOTIMI

Vlerësimet janë të bazuara në vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe objektiv të punimeve të kuvendeve të komunave. Monitoruesit e Organizatës së Shoqërisë Civile Youth Association for Human Rights YAHR kanë përcjellë gjashtë seancat e Kuvendit Komunal të Komunës së Shtimes, gjatë periudhës Janar-Qershor 2019. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në pikë në varësi mbi rendësin e angazhimit të tyre.

KATEGORITË

YAHR në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike në kategoritë e paraqitura në vijim:

1. Propozim për rend dite
2. Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave
3. Pjesëmarrja në diskutime në emër të grupit të anëtarëve
4. Inicimi i çështjeve
5. Amandamentimi i legjislacionit
6. Inicimi i rregulloreve
7. Pyetjet parlamentare
8. Mungesa në seanca
9. Gjuha joparlamentare

PERIUDHA KOHORE

Notimi i anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike është bërë për periudhën Janar – Qershor 2019.



LEGJENDA

- * Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
- ** Udhëheqësi i grupit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- *** Anëtar i ri i Kuvendit të Komunës
- **** Anëtar i Kuvendit që ka ndërruar jetë gjatë mandatit

REZULTATET E FLETËNOTIMIT PËR KUVENDARËT E KUVENDIT


KOMUNA E SHITES

Propozim për rend dite
Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave
Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve
Inicimi i çështjeve
Amandamentimi i legjislacionit
Inicimi i rregulloreve
Pyetjet parlamentare
Mungesa në seanca
Gjuha jo parlamentare
Gjithsej pike

Kuvendarët	Subjekti politik										
PERPARIM RAMUSA	PDK	0	84	0	0	0	0	0	0	0	84 pikë
SHEFKI DAUTI	PDK	4	100	0	0	0	0	30	0	0	134 pikë
HEROLIND SELMANI	PDK	0	12	0	0	0	0	15	0	0	27 pikë
RESHAT MUJOTA	PDK	0	32	0	0	0	0	5	0	0	37 pikë
ARBRESHA SYLA	PDK	0	56	0	0	0	0	10	0	0	66 pikë
MILOT DELIU	PDK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	8 pikë
FATMIRE FERATI	PDK	0	12	0	0	0	0	0	0	0	12 pikë
NAIM ZEJNA	LDK	0	152	0	0	0	0	30	0	0	182 pikë
SKENDER HYSENI	LDK	0	28	0	5	0	0	15	0	0	48 pikë
ZARIFE REXHAJ	LDK	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4 pikë
VALENTINA HALILI	LDK	0	8	0	0	0	0	5	0	0	13 pikë
RUZHDI JASHARI	LVV	2	152	0	5	0	0	40	0	0	199 pikë
BESNIK SEFERI	LVV	2	84	0	0	0	0	55	0	0	141 pikë
MARIGONA PAJAZITI	LVV	0	4	0	0	0	0	10	0	0	14 pikë
FEHMI HYSENAJ	NISMA	0	104	0	5	0	0	125	-2	0	232 pikë
ADELINA BEQAJ	NISMA	0	48	0	0	0	0	5	0	0	53 pikë
ISAK MUSLIJA	AAK	0	64	0	0	0	0	0	0	0	64 pikë
DIARTA VISHESELLA	AAK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0 pikë
MUHAMET ADEMAJ	AKR	0	100	0	0	0	0	60	0	0	160 pikë
REXHEP GASHI	LB	0	68	0	0	0	0	45	0	0	113 pikë

REZULTATET E FLETËNOTIMIT PËR SUBJEKTET POLITIKE

KOMUNA E SHTIMES	Numri i kuvendareve	Propozim për rend dite	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamenti I legjislacionit	Inicimi I rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
PDK	8	4	304	0	0	0	0	60	0	0	368 pikë
LDK	4	0	192	0	5	0	0	50	0	0	247 pikë
LVV	3	4	240	0	5	0	0	105	0	0	354 pikë
NISMA	2	0	152	0	5	0	0	130	-2	0	285 pikë
AAK	2	0	64	0	0	0	0	0	0	0	64 pikë
AKR	1	0	100	0	0	0	0	60	0	0	160 pikë
LB	1	0	68	0	0	0	0	45	0	0	113 pikë



NOTIMI I PËRGJITHSHËM

Kuvendi i Komunës së Shtimes numëron gjithsej 21 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 7 subjekte politike (PDK, LDK, LVV, NISMA, AAK, AKR dhe LB).


Kuvendarët që kanë treguar rezultate më të mira në të gjitha kategoritë janë:	Kuvendarët që kanë treguar rezultatet më të dobëta në të gjitha kategoritë janë:	Kuvendarët që nuk kanë treguar asnjë rezultatet në të gjitha kategoritë janë:
Fehmi Hysenaj Nisma 232 Pikë	Fatmire Ferati PDK 12 pikë	Diarta Vishesella AAK 0 pikë
Ruzhdi Jashari LVV 199 Pikë	Milot Deliu PDK 8 pikë	
Naim Zejna LDK 182 Pikë	Zarife Rexhaj LDK 4 pikë	



PYETJET DHE ÇËSHTJET E INICIUARA

Gjatë seancave të mbajtura në periudhën Janar-Qershor 2019, nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes janë ngritur gjithsej 460 çështje me anë të pyetjeve parlamentare.

KOMUNA E SHITES	Numri i kuvendareve	Inicimi i çështjeve	Pyetjet parlamentare
PDK	8 përfaqësues	0 pikë	60 pikë
LDK	4 përfaqësues	5 pikë	50 pikë
LVV	3 përfaqësues	5 pikë	105 pikë
NISMA	2 përfaqësues	5 pikë	130 pikë
AAK	2 përfaqësues	0 pikë	0 pikë
AKR	1 përfaqësues	0 pikë	60 pikë
LB	1 përfaqësues	0 pikë	45 pikë



Lista e raporteve dhe informata të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2019:

- Raport i punës së Kuvendit për vitin 2018,
- Draft-Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2019
- Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31.12.2018,
- Raporti i aktiviteteve të prokurimit gjatë vitin 2018
- Rregullore për Varreza, ofrimin e shërb. të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre
- Rregullore për Varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre
- Strategjia për Zhvillimin Ekonomik 2019-2022,
- Rregullores së Punës së Kuvendit,
- Raporti tremujor Buxhetor Janar-Mars 2019
- Rishqyrtimi i Rregullores së Punës së Kuvendit, sipas kërkesës së MAPL Nr.0-524/1
- Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022, (pas diskutimit publik)
- Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollor 2018/19

Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2019:

- Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit për 2019

- Vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, N.K. 333/2 me sipërfaqe 11290m², dhe pjesë të N.K 333/3 me sipërfaqe 2170m², në Z.K.-Davidovc
- Vendim paraprak për shpallje me interes të përgjithshëm, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale në Ngastrën me numër: P-72809027-00267-0, me sipërfaqe 849m². Në Zonën Kadastrale Godanc i Poshtëm, evidentuar pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.
- Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesë të Ngastrës Kadastrale me numër, P-00635-2, me sipërfaqe prej 293m² (dyqind e nëntëdhjetë e tre metra katror), në Zonën Kadastrale - Petrovë, evidentuar pronë e Shaban / Sadik / Mehmetit, nga fshati Petrovë.
- Vendim për ristrukturimin e drejtorive të Komunës së Shtimes,
- Vendim për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Rregulloren për Varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, në afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shërbime Publike me Zyrën për Informim.
- Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2018 në vitin 2019,
- Vendim për bashkëpunimin ndër komunal, që do të zhvillohet ndërmjet dy Komunave të Shtimes dhe Komunës së Ferizajt,
- Vendim për ndarjen e truallit (oborr) për ndërtimin e Objektivit të Bibliotekës dhe Arkivit të qytetit të Shtimes, me sipërfaqe prej: 2653m² (dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tri) metra katror në Ngastrën Kadastrale Nr.1406/2, Zona Kadastrale – Shtime, evidentuar, Pronë Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime,
- Vendim që t'i japë në shfrytëzim afatgjatë pasurinë e patundshme të Komunës së Shtimes me sipërfaqe prej 849m² në Zonën Kadastrale – Godanc i Poshtëm, në afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, me kompensim, firmës DPZ “PRO METAL” me pronarë z. Agim Halimi, nga fshati Godanc i Poshtëm,

Lista e kërkesave të aprovuara nga Kuvendi komunal të vitit 2019:

- Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm, Ngastrën Kadastrale Nr.357-0, Zona Kadastrale – Davidoc, evidentuar pronë e Jakup /Abdul/ Azizi, me sipërfaqe prej 295m² (dyqind e nëntëdhjetë e pesë) metra katror, me arsyetimin se shpallja me interes të përgjithshëm të pjesës të Ngastrës Kadastrale me numër Nr.357-0, me sipërfaqe prej 295 m², është bërë me qëllim të zgjerimit të rrugës “Emini” në fshatin Davidoc. Shpronësimi i kësaj prone do të trajtohet sipas Ligjit nr 03/L–139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimin dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205. Sipërfaqja e pjesës së parcelës Nr.357-0 e cila është shfrytëzuar nga Komuna e Shtimes për rrugë, sipas

matjeve gjeodezike është 295m² të kryera në bazë të kërkesës së palës, po ashtu nga zyra e Kadastrit është definuar se sipërfaqja për shpronësim është rruga së bashku me bankinë.

- *Vendim që t'i lejoj komunitetit të fshatit Gllavicë për ta shfrytëzuar përkohësisht, pjesën e ngastrës kadastrale Nr.765-0, Z.K-Rashincë me një sipërfaqe prej S=500m², evidentuar Pronë Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime, për t'i zhvilluar aktivitetet e ngushëllimeve.*
- *Vendim që t'i lejoj komunitetit të fshatit Petrovë për ta shfrytëzuar përkohësisht, ngastrën kadastrale Nr.686-2, Z.K.-Petrovë me një sipërfaqe prej S=685m², evidentuar Pasuri Shoqërore e Entit Shëndetësor, për ndërtimin e objektit për aktivitetet e ngushëllimeve.*

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Janar - Qershor 2019.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar - Qershor 2019
3. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Shtimes, Janar - Qershor 2019,.
4. Komunikatat për media të YAHR-it Janar - Qershor 2019.
5. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal , Janar - Qershor 2019,
6. <https://kk.rks-gov.net/shtime/> .

